



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme

Nr. 41

Prishtinë, më 20.09.2010, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

Nga Samiti i kryetarëve të komisioneve të Punëve të Jashtme të parlamenteve të vendeve të Evropës Jug-Lindore

Në Samit nga Komisionet e Punëve të Jashtme të parlamenteve të vendeve të Evropës Jug-Lindore, morën pjesë delegacionet: z. Fatos Beja, kryetar dhe znj. Arta Dade, nënkryetare e Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë, z. Dobroslav Dimitrov, kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme dhe të Mbrojtjes të Kuvendit të Bullgarisë, Kresimir Cosic, anëtar i Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Kroacisë, znj. Teuta Arifi, kryetare e Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Maqedonisë dhe znj. Ljilja Trpovska e znj. Bleta Bejtullahu nga Stafi i Komisionit, z. Miodrag Vukovic, kryetar i Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet Evropian të Kuvendit të Malit të Zi, z. Genci Nimanbegu, anëtar i Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet Evropian të Kuvendit të Malit të Zi dhe znj. Andjela Radunoviq nga Stafi i Komisionit, dhe z. Mehmet Ceylan, zëvendëskryetar i Komisionit për Punë të Jashtme të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë.

Nga anëtarët e Komisionit morën pjesë: z. Sabri Hamiti, z. Xhavit Haliti, z. Enis Kervan, z. Ramë Buja, z. Alush Gashi, z. Nexhat Daci z. Ibrahim Gashi, dhe z. Slobodan Petroviq.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit ishin të pranishëm: Minire Hasani, dhe Manush Krasniqi.

Samitin e kryesoi : Sabri Hamiti, kryetar i Komisionit, me temën:

Bashkëpunimi Rajonal dhe Integritet Evropian

Sabri Hamiti - Në fjalimin hyrës të kryetarëve dhe përfaqësuesve të Komisioneve për Punë të Jashtme të parlamenteve të vendeve të Evropës Jug-Lindore, tha se në vendet e Ballkanit kanë ndodhur ndryshime të mëdha. Në Kosovë ka pasur zhvillime të mëdha historike e politike, shpallja pavarësinë e saj, e legjitimuar nga GJND, nga Rezoluta e OKB - së, dhe njohja tani për tani nga 70 shtete. Tani Kosova është faktor stabiliteti në rajon, synim po ashtu edhe i vendeve të Ballkanit, është bashkëpunimi rajonal dhe integritet evropian.

Jakup Krasniqi – I përshëndeti të pranishmit dhe këtë takim e konsideroi dëshmi të marrëdhënies të mira në mes të popujve të këtyre vendeve dhe angazhim drejt bashkëpunimit rajonal ndërparlamentar dhe ndërshtetëror. Falënderoi vendet e të

pranishmëve në këtë Samit, për njohjet e hershme të pavarësisë së Kosovës. Në vazhdim njoftoi për angazhimet dhe të arriturat e Republikës së Kosovës dhe të Kuvendit, mbështetur në parimet demokratike.

Fatos Beja, kryetar i Komisionit të Politikës së Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë - Tha se është në interes të vendeve të rajonit edhe në interes të BE - së, që të mos kemi kufij të jashtëm me BE - në, që tregu i brendshëm i rajonit të mos jetë treg i jashtëm për këtë bashkim, që lëvizja e qytetarëve tanë të mos ketë barriera kufizuese administrative. Dokumentet e fundit ndërkombëtare për Kosovën, opinioni i GJND - së dhe Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB - së, që e konfirmojnë legjitimitetin e pavarësisë së Kosovës, krijojnë garanci për stabilitetin dhe paqen e rajonit tonë, dhe meritojnë të mbështeten nga ky Samit.

Dobroslav Dimitrov, kryetar i Komisionit të Politikës së Jashtme dhe të Mbrojtjes në Kuvendin Kombëtar bullgar - Tha se në këtë Samit jemi nga vendet me pozita të ndryshme rreth integritetit në BE. Për rajonin është i nevojshëm ndërtimi i infrastrukturës rrugore, sepse lëvizja e shpejtë dhe e lirshme ndihmon që të jemi konkurrues në aspektin global. Deklaroi se Bullgaria është vend mik i vendeve të rajonit dhe shprehu gatishmërinë për takime më të shpeshta të kësaj natyre, dhe ofrimin e përvojës së Bullgarisë për integritet në NATO dhe BE.

Kreshimir Qosiq, anëtar i Komisionit për Politikë të Jashtme në Parlamentin e Kroacisë - Theksoi se Kosova ka pasur përkrahjen e Kroacisë, e po ashtu si anëtare e ardhshme e BE-së do ta ketë përkrahjen drejt procesit të integritetit evropian. Njoftoi për fazën në të cilën gjendet Kroacia dhe angazhimet e saja për përmbushjen e kriterëve për anëtarësim në BE. Njëkohësisht theksoi se marrëdhëniet e mira fqinjësore janë parakusht për paqen e tërë rajonit. Mendon se duhet të krijohet një lidhje më e fuqishme me shtetet e rajonit në fushën e komunikacionit, energjisë, tregtisë, turizmit, sigurisë kufitare, policisë, gjyqësisë, arsimit e shkencës. Vendet e rajonit duhet të kenë një ekonomi të zhvilluar, që të konkurrojmë në tregun e përbashkët evropian.

Teuta Arifi, kryetare e Komisionit për Politikë të Jashtme, në Parlamentin e Maqedonisë - Tha se shtetet e dala nga shpërbërja e Jugosllavisë janë shtete fragjile nga aspekti i sigurisë, i standardeve demokratike, respektit të të drejtave të njeriut, dhe të drejtave ndëretnike. Ajo ka shprehur kënaqësinë që tanimë edhe vendi i saj, si shumica e vendeve të rajonit, po e krijojnë mentalitetin për një Ballkan të evropianizuar. Gjë që duhet të nënvizohet nga të gjithë në këtë takim, është Rezoluta e fundit për Kosovën, që flet edhe për gatishmërinë e të menduarit, me një logjikë më të avancuar. Maqedonia ka njohur pavarësinë e Kosovës, ka të nënshkruara disa marrëveshje bashkëpunimi, si dhe ka të rregulluar vijën e demarkacionit me Kosovën. Kërkoi që diplomacia parlamentare të bëjë një hap më tepër, të jetë më kritike sa u përket proceseve demokratike.

Miodrag Vuković, kryetar i Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet Evropian në Parlamentin e Malit të Zi - Tha se duke iu kthyer zhvillimeve konfliktuale në ish-Jugosllavi dhe pamundësisë që konfliktet të zgjidheshin paqësisht, vendi i tij i vogël zgjodhi rrugën e mbijetesës së vet politike, duke e shpallur pavarësinë dhe bashkëpunuar ngushtësisht për integritet evropian dhe euroatlantike. Ai ka përmendur pjesëmarrjen e vendit të tij në disa nisma rajonale, kurse ka veçuar bashkëpunimin e mirë me të gjitha vendet e rajonit. Ka vlerësuar sidomos investimet turke në projekte të mëdha në Mal të Zi, si dhe hapjen e shumë pikave të rejave kufitare me Shqipërinë që e

lehtësojnë lëvizjen e qytetarëve. Ai ka pohuar se me Kosovën do të këmbehen ambasadorët respektivë.

Mehmet Ceylan, zëvendëskryetar i Komisionit të Punëve të Jashtme të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë - Theksoi problemet që i kanë shkaktuar paqes në Evropë shpërbërja e Bashkimit Sovjetik edhe e Jugosllavisë Federale, por ka vënë në pah se me pavarësimin e Malit të Zi dhe Kosovës është formësuar harta politike e Ballkanit. Ballkani nuk duhet të jetë periferi e Evropës, por pjesë e saj, ka thënë Ceylan, i cili në vazhdim ka folur për prioritetet e Turqisë në rrugët e saja të zhvillimit e të afirmimit ndërkombëtar. Ai, ndërkaq, ka theksuar lidhjet e shumëfishta historike, kulturore e fetare të Turqisë me vendet e rajonit, sidomos me Kosovën, prandaj edhe interesin e vendit të tij për ta mbështetur Kosovën, në shumë plane. Ai ka apeluar që Serbia t'i kthehet realitetit dhe të jetë konstruktive në të ardhmen.

Xhavit Haliti - Përkujtoi faktin e njohur, se Kosova si gjatë historisë, por edhe pas shpalljes së pavarësisë, e njohur nga 70 shtete, u përballë me Serbinë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe GJND në Hagë.

Në mes të tjerash tha se bashkëpunimi rajonal nuk kushtëzohet aq nga vullneti dhe predispozita politiko - shtetërore e vendeve fqinje, sesa nga miqësia e detyrueshme gjeografikisht dhe historikisht e tyre. Kosova si pjesë e Ballkanit dhe në distancë hapësinore më të afërt me Brukselin se me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ndihet shumë larg BE - së, në krahasim me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Kjo si pasojë e qëndrimit dyshues të BE - së ndaj Ballkanit, që shfaqet edhe me qëndrimin ndaj Turqisë e Kroacisë, të cilat do të duhej të ishin prej vitesh anëtare të BE-së. Kosova nuk pretendon të integrohet në BE, para se të anëtarësohet në OKB. Bashkëpunimi rajonal dhe siguria rajonale nuk do të mbeten peng dhe nuk do të kushtëzohen kurrë drejtpërsëdrejti nga raportet Prishtinë - Beograd, sepse Prishtina shtetërore e politike si deri tani, është dhe do të jetë konsekuente dhe e vendosur në mbështetje dhe në mbrojtje të sigurisë dhe të stabilitetit në rajon.

Nexhat Daci - Ceku se si elemente të përbashkëta të vendeve të rajonit janë afërsia e tyre gjeografike, po ashtu përcaktimin drejt integriteteve evropiane. Çështje tjetër mbetet përshpejtimi i rrugës drejt integriteteve evropiane, që mendon se është e lidhur ngushtë me pozitën demokratike të komuniteteve në vendet e tona. Kjo është çështje kryesore për të cilën Bashkësia Ndërkombëtare, në veçanti BE, na monitoron. Diplomacia parlamentare do ta ndihmonte shumë procesin e integritetit të komuniteteve dhe do ta shkurtonte rrugën e integriteteve evropiane dhe euroatlantike.

Arta Dade, nënkryetare e komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Shqipërisë - Tha se rajoni ka ecur mjaft përpara dhe është afruar me njëri - tjetrin. Mbështeti mendimin se diplomacia parlamentare, është një nga segmentet më të rëndësishëm të diplomacisë në përgjithësi. Në mes të tjerash në diskutimin e saj kërkoi që këto takime të komisioneve të jashtme të vendeve të rajonit të institucionalizohen, e po ashtu të veprohet edhe me komisionet e tjera, si atë të ekonomisë, energjisë e tjera.

Ibrahim Gashi - Në diskutimin e tij tha se perspektiva euroatlantike e rajonit, është ngushtë e lidhur me progresin e brendshëm, në konsolidimin e demokracisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Efektet e punës në këtë Samit, do të reflektojnë edhe te qarqet më të larta të vendimmarrjes të vendeve respektive.

Enis Kervan - Tha se të gjithë në këtë Samit, pajtohen se alternativë e vetme e rajonit është Evropa dhe se bashkëpunimi rajonal është i domosdoshëm. Përderisa me Turqinë dhe Shqipërinë nuk ka pengesa në qarkullim, theksoi se duhet bërë një lehtësim i vizave me Bullgarinë dhe Kroacinë. Kosova është një shtet i ri me të drejta të garantuara të të gjitha komuniteteve.

Slobodan Petroviq - Njoftoi për angazhimet e komunitetit serb në institucionet e Kosovës dhe zgjedhjet e fundit lokale. Në mes tjerash tha se synim i yni është të jemi pjesë e Evropës.

Genci Nimanbegu, anëtarë i Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet Evropiane të Kuvendit të Malit të Zi - Tha se është mirë që përvojën që kemi në shtetet tona në këto forma ta ndajmë me njëri - tjetrin dhe në këtë mënyrë t'i japim mbështetje edhe më tepër bashkëpunimit rajonal. Ne kemi një synim të përbashkët integritet evropiane dhe standardet e përbashkëta demokratike. Ngritja e infrastrukturës rrugore do të ndikonte në një shkallë më të madhe të bashkëpunimit ekonomik, por një bashkëpunim i nevojshëm do të duhej të zhvillohej edhe në sferën edukimit e kulturës.

Pas diskutimeve të pjesëmarrësve të Samitit, është miratuar njëzëri një deklaratë e përbashkët e kryetarëve dhe përfaqësuesve të Komisioneve të Jashtme të parlamenteve të vendeve të Evropës Jug-Lindore, me tekstin si vijon:

DEKLARATË

Të mbledhur në Samitin e kryetarëve të komisioneve për Politikë të Jashtme të parlamenteve të Evropës Jug-Lindore, të mbajtur në Prishtinë, më 20 shtator 2010, kryetarët e përfaqësuesit e komisioneve të Politikës së Jashtme të vendeve të rajonit: Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Maqedoni, Mali i Zi, Turqi e Kosovë, në mbarim të diskutimit për “ Bashkëpunimin rajonal dhe integritet evropiane”, miratuan këtë deklaratë:

1. Shprehim përkushtimin për intensifikimin e bashkëpunimit ndërparlamentar rajonal në të gjitha fushat e veprimtarisë parlamentare;
2. Përkrahim fuqishëm politikat e integritetve Euro-Atlantike dhe bashkëpunimin për arritjen e standardeve demokratike dhe të vlerave evropiane;
3. Angazhohemi për lëvizje të lirë të qytetarëve në hapësirën evropiane dhe përkrahim liberalizimin e vizave për qytetarët e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor;
4. Shprehim qëndrimin që pavarësia e Kosovës është bërë faktor i stabilitetit në rajon, duke hapur perspektiva për integritet rajonale dhe evropiane dhe, me këtë synim, ftojmë vendet fqinje e të tjerët që ta njohin pavarësinë e Kosovës;
5. Mbetemi të përkushtuar për promovimin e dialogut në interes të popujve e të shteteve të rajonit dhe në frymën e Rezolutës së Asamblesë së OKB-së të datës 9 shtator 2010, inkurajojmë dialogun në mes të Kosovës e të Serbisë për çështje të interesit të përbashkët.

Samiti përfundoi në orën 16:40.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetje të Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti